

# BULETINI INFORMATIV

JANAR

2026



Gjatë muajit janar, ERE ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë së saj rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi licencimet e reja, publikimet, të dhënat e tregut, çmimet e shitjes së energjisë elektrike si dhe dokumentet/aktet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik. Synimi ynë mbetet garantimi i transparencës, rritja e eficiencës dhe mbështetja e zhvillimit të tregut të energjisë në vend.

Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

## Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit janar

Gjatë muajit janar 2025, Bordi i ERE ka zhvilluar 4 mbledhje vendimmarrëse për të cilat është bërë njoftimi të paktën 24 orë përpara edhe në rrjetet sociale të institucionit, duke ftuar të gjitha palët e interesit të ndjekin mbledhjet online. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 21 vendime, që përfshijnë: fillimin e procedurave të reja të licensimit; licensime; autorizime; pezullim apo zgjatje të afateve vendimmarrëse; rishikimin e akteve rregullatore si dhe fillimin e procedurave për rishikimin e rregulloreve të miratuara më parë, të cilat aktualisht janë objekt i konsultimit publik. Një përmbledhje e vendimmarjes së Bordit është publikuar pas çdo mbledhje në rrjetet sociale. Ndërsa vendimet e plota gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë [vendimet](#) si dhe në Fletoren Zyrtare.

## Procedura të filluara gjatë muajit janar 2026

**Gjatë muajit janar, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka filluar procedurën për:**

rinovimin e licencës së shoqërisë “INFO-TELECOM” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;  
·licencimin e shoqërive “FAVINA.1. SH.P.K” sh.p.k. dhe “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe gjithashtu, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarjes respektive të rinovimit /licensimit ose jo.

## Vlerësimi i Raportit Vjetor të Përputhshmërisë të shoqërisë Albgaaz sh.a

Në muajin janar 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) mori vendimin lidhur me vlerësimin e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë të shoqërisë Albgaaz sh.a., në kuadër të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës për zbatimin efektiv të Programit të Përputhshmërisë.

Vlerësimi u fokusua në përputhshmërinë e veprimtarisë së Albgaaz sh.a. me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për sektorin e gazit natyror, si dhe në masat e ndërmarra për garantimin e pavarësisë e operatorit, mosdiskriminimit dhe transparencës në ushtrimin e aktivitetit të tij, ERE evidentoi aspektet pozitive të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë, si dhe identifikoi fusha që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm, duke adresuar rekomandime konkrete.

# BULETINI INFORMATIV

JANAR

2026



## Vendime të ndërmjetme

Gjatë muajit janar, Bordi i ERE-s ka vendosur të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Po ashtu gjatë muajit janar 2026, Bordi i ERE-s ka vendosur të pezullojë afatet e vendimmarrjes për aplikimin për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin e dokumentacionit të munguar, për shoqëritë si vijon:

**“SUNPRO” sh.p.k.** për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë, e lidhur kjo vendimarrje me nevojën për depozitimin nga ana e shoqërisë të përgjigjes/qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për kërkesën e bërë nga ana e saj në lidhje me shtyrjen e afateve për pajisjen me lejet e nevojshme, ndërtimin dhe vënien në punë të parkut eolik.

**“PROSOL” sh.p.k.** për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, e kushtezuar kjo vendimarrje nga depozitimi nga ana e shoqërisë të përgjigjes/qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për kërkesën e bërë nga ana e saj në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar të parkut fotovoltai.

## Autorizime për garanci financiare

Gjatë muajit janar 2016, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesat për marrje aurotizimi si vijon:

### Transferim asetesh

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse, si mjete për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a, për shoqërinë “AGE ERZEN sh.p.k, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Hekali” me kapacitet prodhues 1.94 MW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a., për shoqërinë “AGE ERZEN sh.p.k, licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024, nga HEC “Hekali” me kapacitet prodhues 1.94 MW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

### Ndryshim i ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “RENEW” sh.p.k, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet 2 MW në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

### Vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “ProCredit Bank” sh.a., për shoqërinë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 14.02.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet 2 MW, në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

# BULETINI INFORMATIV

JANAR

2026

## Aktivitetet e ERE për Konsumatorët

Gjatë muajit janar ofertat e publikuara në Platformën e krahasimit të çmimeve të energjisë elektrike (PCT) të rifreskuara kanë qënë ato të Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL sh.a). Këto oferta përbëjnë çmimin aktual me të cilin Furnizuesi i tregut të lirë, ofron shërbimin e furnizimit sipas niveleve të ndryshme të tensionit në të cilin janë lidhur konsumatorët të cilët kanë dalë në treg të lirë

Po ashtu gjatë këtij muaji janë në proces shqyrtimi dy procedura administrative. Ajo për rishikimin e standardeve të cilësisë së shërbimit të furnizimit në rrjetin e transmetimit për të cilën është organizuar dhe një seancë dëgjimore me palët e interesit ashtu edhe procedura për rishikimin e standardeve të rrjetit të shpërdarjes. Gjatë këtij muaji janë përcjellë dhe vlerësuar komentet e palëve të interesit.

## Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit janar është përditësuar informacioni në webin e ERE-s [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) dhe rrjetet sociale me [vendime, njoftime të mbledhjeve](#), njoftime mbi [aplikime të reja për licencim](#) si dhe [çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025](#).

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))

## Tregu i energjisë

Përgjatë këtij muaji një volum total prej 2,772.56 MWh i energjisë elektrike u tregtua në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë të ALPES-it me një çmim klerues mesatar prej 130.05 €/MWh ku rrjedha e energjisë nga Zona e Ofertimit të Shqipërisë drejt Zonës së Ofertimit të Kosovës ishte 1,016.01 MWh, ndërsa nga Zona e Ofertimit të Kosovës drejt Zonës së Ofertimit të Shqipërisë ishte 111.38 MWh. Gjithashtu gjatë këtij muaji ALPES mirëpriti një anëtar të ri për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, në Tregun e Ditës në Avancë dhe në Tregun e Ankandëve brenda të Njëjtës Ditë, përkatësisht shoqërinë “Egnatia Hydropower” sh.p.k.

## Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e datës 15.01.2026 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2025, në vlerën 15.98 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Ky çmim rezultoi më i lartë krahasuar me muajin nëntor 2025, i cili ishte 14.52 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, koston e rrjetit dhe koston administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin dhjetor 2025, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 12.15 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 130.19 MWh. Ndërkohë, për muajin nëntor 2025, kosto përkatëse ka rezultuar 10.74 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 113.51 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin dhjetor është rritur rreth 13.1% në raport me muajin nëntor, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është rritur rreth 14.7%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në fillim të vitit 2025. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

## Vendime licencimi

Gjatë muajit janar është licencuar “FAVINA.1. SH.P.K” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.